

**VENDIM**  
**Nr. 206, datë 25.3.2021**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË STACIONIT TË ZJARRFIKËSES DHE TË GODINËS SË BORDIT TË KULLIMIT, BASHKIA KAVAJË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAVAJË SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në vlerën 227 211 426 (dyqind e njëzet e shtatë milionë e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të stacionit të zjarrfikëses dhe godinës së bordit të kullimit, Bashkia Kavajë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Rindërtimi i stacionit të zjarrfikëses, Bashkia Kavajë, në vlerën 79 301 115 (shtatëdhjetë e nëntë milionë e treqind e një mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH;

b) Rindërtimi i godinës së bordit të kullimit, Bashkia Kavajë, në vlerën 147 910 311 (njëqind e dyzet e shtatë milionë e nëntëqind e dhjetë mijë e treqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

2. Bashkisë Kavajë, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 45 442 285 (dyzet e pesë milionë e katërqind e dyzet e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Për rindërtimin e stacionit të zjarrfikëses, Bashkia Kavajë, në vlerën 15 860 223 (pesëmbëdhjetë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e dyqind e njëzet e tre) lekë pa TVSH;

b) Për rindërtimin e godinës së bordit të kullimit, Bashkia Kavajë, në vlerën 29 582 062 (njëzet e nëntë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

3. Caktimin e Bashkisë Kavajë si njësi zbatuese për rindërtimin e stacionit të zjarrfikëses dhe godinës së bordit të kullimit.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**